



INVESTIMET E HUAJA DIREKTE SHËNOJNË REKORD TË RI NË 3-MUJORIN E PARË 2025

Shqipëria është shndërruar në një destinacion kryesor për Investimet e huaja me kulturën e saj urbane, disponueshmërinë e burimeve, infrastrukturën dhe incentivat tërheqëse për investimet.

Me një fluks prej 362 milionë € gjatë Janar-Mars 2025, ky është niveli më i lartë i regjistruar ndonjëherë për këtë periudhë.

Kryesojnë investitorët nga:

- ◆ Turqia – 13.8%
- ◆ Holanda – 13.5%
- ◆ Italia – 12.7%
- ◆ Austria – 8.6%
- ◆ Gjermania – 7.7%

Sektorët me më shumë investime:

- ◆ Pasuri të paluajtshme – 28.7%
- ◆ Financa dhe sigurime – 20.7%
- ◆ Industri nxjerrëse – 14.1%
- ◆ Përpunim dhe tregti – 8.8% secila

Ky është një tregues i qartë i besimit të investitorëve të huaj në klimën tonë ekonomike dhe potencialin që ofron Shqipëria.



Eksportet shqiptare janë rritur në 6-mujorin e parë 2025

Shifrat në 6-të mujorin e parë të vitit 2025 krahasur me vitin 2024 janë pozitive. Eksportet u rritën me +2.1%, duke arritur në 203 miliardë lekë. Grupet me ndikim më të madh në rritje:

+8.6% rritje për mineralet, lëndët djegëse dhe energjinë elektrike
+1.2% rritje për ushqime, pije dhe duhan

Kontribuesit më të mëdhenj të rritjes:

-Kosova +72.5%,
-Gjermania +10.3%
-Greqia +8.6%

Ekonomia shqiptare po tregon qëndrueshmëri dhe rritje të qëndrueshme në eksportet rajonale dhe europiane!



Shqipëria po rritet si destinacion i preferuar për investitorët ndërkombëtarë

Për vetëm 3 muaj, regjistrimi i bizneseve me pronësi të huaj dhe partneritetet shqiptaro-të huaja ka pasur një rritje të dukshme. Ky është një tregues se Shqipëria nuk është vetëm një destinacion outsourcing-u, por partneri yt për rritje globale!

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka patur një rritje +44% – një shenjë e fortë besimi në tregun shqiptar, dhe një rritje e interesit nga investitorët globalë.

Shqipëria po bëhet një pikë kyçe për nisma biznesi me vizion global.

Drejtoresha ekzekutive pret në zyrat e AIDA-s zyrtarin e lartë të Kirgistanit

Drejtoresha ekzekutive e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve znj. Laura Saro mirëpriti në një takim zyrtar ambasadorin e Kirgistanit në Turqi, z. Ruslan Kazakbaev, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dypalësh për rritjen e investimeve në Shqipëri dhe mbështetjen e sipërmarrjeve të dy vendeve.

Gjatë bisedimeve, u ra dakord për një bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Agjencisë Kombëtare të Investimeve të Kirgistanit.

Palët theksuan angazhimin për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si forume biznesi dhe vizita reciproke të sipërmarrësve, me qëllim promovimin e mundësive investuese në Shqipëri. Një element kyç ishte edhe shpërndarja e informacionit për sektorët strategjikë dhe lehtësitë e ofruara në vendin tonë.

Ky takim përfaqëson një hap konkret drejt zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike Shqipëri-Kirgistan, duke u fokusuar në shkëmbimin praktik të mundësive dhe përvojave ndërmjet investitorëve të dy vendeve.





Platforma EXPORT ALBANIA - Workshop “Gatishmëria për Eksport”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në bashkëpunim me GIZ Albania dhe Damiani & Partners organizoi workshopin “Gatishmëria për Eksport”, ku trajnoi bizneset pjesëmarrëse mbi platformat, instrumentat dhe mekanizmat që duhen ndjekur për të hyrë në tregje të reja si dhe këshilla ligjore për aspektet juridike të eksportit.

Qëllimi i kësaj iniciative, e mbështetur nga partnerë të fuqishëm (agjencia qeveritare, bashkëpunim ndërkombëtar, ekspertizë ligjore), është pajisja e bizneseve shqiptare me njohuritë dhe mjetet praktike për të dalë me sukses në tregjet e huaja.

Kjo praktikë paraqitet si një mundësi e rëndësishme për bizneset që duan të diversifikojnë tregjet e tyre dhe të bëhen konkurese ndërkombëtarisht.



AIDA-Takim me përfaqësues të kompanisë Metalogalva

AIDA zhvilloi një takim produktiv me përfaqësues të Metalogalva, kompani e cila njihet si lider në fushën e prodhimit të strukturave metalike dhe galvanizimit.

Gjatë takimit, u theksuan avantazhet që Shqipëria ofron si një destinacion konkurrues për investitorët e huaj. Diskutimi u përqendrua në identifikimin e zonave të përshtatshme, me përparësi logjistike për kompaninë dhe njëkohësisht, evidentimin e lehtësirave fiskale të garantuara nga kuadri ligjor për investimet në vend.

Ndër pikat kryesore të trajtuara ishin klima e favorshme për investime, procedurat e thjeshtuara ligjore, si dhe tendencat në zhvillim të tregut të punës në Shqipëri.

AIDA konfirmoi gatishmërinë e saj të plotë për të mbështetur kompaninë Metalogalva në çdo fazë të projektit të investimit, në mënyrë që të garantohet një hyrje e suksesshme në tregun shqiptar.



AIDA-Takim me përfaqësuesin e kompanisë Secitops

Në kuadër të fushatës outreach në sektorin ICT/BPO, AIDA zhvilloi një takim me Z. Korab Gashi, përfaqësuesin e kompanisë Secitops, në bashkëpunim me ABSL Albania. Qëllimi i takimit ishte eksplorimi i interesit të kompanisë për investim në Shqipëri, veçanërisht në fushën e financës digjitale dhe shërbimeve të biznesit.

Secitops është një kompani që operon në sektorin e teknologjisë, e fokusuar në fushën e transaksioneve digjitale, sistemeve të pagesave dhe shërbimeve fintech. Me një prani në rritje në tregjet ndërkombëtare, kompania po kërkon tregje të reja që ofrojnë një klimë institucionale mbështetëse ndaj inovacionit. Potenciali i Shqipërisë si një destinacion në zhvillim për shërbimet ICT/BPO, si dhe ekosistemi në zgjerim i fintech, tërhoqën vëmendjen e Secitops dhe interesin për realizimin e këtij takimi.

Gjatë takimit u mundësua prezantimi i Shqipërisë si një vend me fuqi punëtore të kualifikuar dhe një vendndodhje strategjike për kompanitë që synojnë tregun e BE me kosto konkurruese. Secitops theksoi se një mjedis i favorshëm institucional do të jetë thelbësor për realizimin e këtij projekti.

GAIDA do të qëndrojë në komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e kompanisë për asistencën e nevojshme për realizimin e investimit në Shqipëri.



AIDA ju fton të merrni pjesë në edicionin e pestë të Forumit Ekonomik të Tiranës

AIDA ka kënaqësinë të njoftojë organizimin e edicionit të pestë të Forumit Ekonomik të Tiranës pjesë e organizimit të Delphi Economic Forum, ky forum do të zhvillohet më 20–21 tetor 2025, në Tiranë. Tema e këtij edicioni do të jetë:

“Drejt së ardhmes: Shqipëria, rritja e qëndrueshme në ekonominë rajonale.”

Pas suksesit të edicionit të katërt të mbajtur në vitin 2022, ky forum rikthehet si një platformë strategjike për të theksuar rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të Shqipërisë në zhvillimet ekonomike të rajonit.

Në qendër të diskutimeve do të jetë trajektorja pozitive e zhvillimit ekonomik të vendit, reformat dhe rritja e qëndrueshme në përputhje me objektivat afatgjata.

Forumi do të shërbejë si një pikëtakim mes aktorëve institucionalë, partnerëve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të biznesit, për të ndarë vizionin dhe angazhimin drejt një të ardhmeje të qëndrueshme.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet integritimit evropian dhe rrugës së Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian, me vizionin “Shqipëria 2030”.

Tema të rëndësishme si energjia, zhvillimi i qëndrueshëm, infrastruktura moderne dhe roli i Shqipërisë si një qendër rajonale për këto fusha do të jenë pjesë e diskutimeve mes liderëve të rajonit dhe përtej tij.





Akses në Financë

www.aida-smefinance.gov.al

AIDA ju prezanton me thirrjen më të re të publikuar: HORIZON_ Cluster 6 Call 02 single stage

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: HORIZON_ Cluster 6 Call 02 single stage (HORIZON-CL6-2025-02)

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://lnkd.in/emBxN7YP>

AIDA ju prezanton me thirrjen më të re të publikuar: SKI.F.T. (Skills for Transition) | Cascade Funding

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: SKI.F.T. (Skills for Transition) | Cascade Funding

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://lnkd.in/eeCSvkVg>



AIDA ju prezanton me thirrjen më të re të publikuar: ERA Fellowships | HORIZON EUROPE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: ERA Fellowships | HORIZON EUROPE

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://lnkd.in/e2UYTU43>



AIDA ju fton të merrni pjesë në Panairin e Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së Gjelbër (ECGE25)

AIDA do të jetë pjesë e Panairit të Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së Gjelbër (ECGE25) do të zhvillohet më 29-30 Tetor 2025 në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, duke shënuar një nga eventet kryesore për këto sektorë strategjikë me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e vendit dhe rajonit.

Me mbi 100 entitete dhe biznese të përfaqësuara do të gjeni, partneritete, furnitorë, produktet inovatore në treg, të gjitha në një event të vetëm për energjinë.



AIDA-pjesë e “Organic Expo Dubai 2025” në datat 17-19 nëntor 2025, Dubai

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), për herë të parë do të organizojë stendën e Shqipërisë në panairin “Organic Expo Dubai 2025”, dedikuar sektorit të produkteve ushqimore që do të zhvillohet në datat 17-19 nëntor 2025, në Dubai.

Ky panair është shfaqja e vetme e dedikuar për promovimin e produkteve organike dhe natyrore, duke krijuar një përvojë unike që bashkon produktet më të mira organike dhe natyrore në botë.

Kriteret kryesore të pjesëmarrjes si ekspozitor:

- Të jenë kompani të regjistruara dhe aktive në fushën e sektorit të ushqimeve;
- Të mbulojnë kostot e udhëtimit dhe tarifën e shpenzimeve për marketingun dhe promovimin e kompanisë në mediat e panairit në vlerën 450 dollarë;
- Të marrin pjesë aktive në fazën përgatitore, në bashkëpunim me ekspertë të huaj;
- Përfaqësuesit e kompanisë të jenë njohës të gjuhës angleze;
- Pjesëmarrja e kompanive në këtë panair do të nxisë eksportet e produkteve shqiptare dhe do të rrisë shkëmbimet tregtare midis dy vendeve.

Në edicionin e vitit të kaluar morrën pjesë 550 ekspozues, 15,200 vizitorë dhe u organizuan 3067 takime B2B.

AIDA ju fton të merrni pjesë në Panairin e Energjisë, MAKTEK 2025

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ju fton të merrni pjesë në MAKTEK 2025 – Panairi i Madh i Industrisë së Makinerive në Anadoll (Azia e Vogël), që do të zhvillohet për herë të tretë në qytetin industrial të Konyas, në 🇹🇷 Turqi, nga data 8 deri më 11 Tetor 2025.

MAKTEK 2025 përfaqëson një nga ekspozitat më të rëndësishme të teknologjive të përpunimit të metaleve, pajisjeve industriale, mjeteve të prerjes, automatizimit dhe robotikës në rajon, ku marrin pjesë kompanitë më të mëdha të industrisë së makinerive nga Turqia, Europa dhe më gjerë.

Çfarë ofron panairi:

- Prezantimi i risive teknologjike dhe zgjidhjeve industriale;
- Platformë ideale për rrjetëzim dhe zgjerim të kontakteve profesionale, si dhe për krijimin e partneriteteve të reja ndërkombëtare;
- Takime me furnitorë, investitorë dhe ekspertë të sektorit;
- Hapësira të dedikuara për bashkëpunim B2B;
- Konferenca dhe trajnime për trendet më të reja në automatizim dhe prodhim;
- Tregje të reja për bizneset shqiptare në Turqi dhe rajon.

Pjesëmarrja mund të jetë një investim i dobishëm për biznesin tuaj!

Për më tepër informacion dhe regjistrim, ju lutemi vizitoni faqen zyrtare të panairit: <https://lnkd.in/dBwrfZB3>



AIDA ju fton të merrni pjesë në Panairin e 4-ërt Ndër-Afrikan të Tregtisë (IATF2025)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) njofton kompanitë shqiptare se zhvillohet Panairi i 4-ërt Ndër-Afrikan i Tregtisë (IATF2025), organizuar nga Afreximbank në partneritet me Komisionin e Bashkimit Afrikan dhe Sekretariatit e AfCFTA-s.

-Sektorët Kryesorë të Panairit përfshijnë: Bujqësia & Përpunimi Agro, Tekstile & Veshje, Energjia & Infrastrukturat, Teknologjia e Informacionit & Inovacioni, Automobilët, Shëndetësi & Farmaceutikë, Industritë Kreative, Start-up-e & Diaspora, Financa, Edukimi, Miniera, Logjistika, Turizmi, Transporti, etj.

-Pse të merrni pjesë në IATF2025?

Akses në një treg me mbi 1.4 miliardë konsumatorë

Pjesëmarrje në një ngjarje me një PBB mbi 3.5 trilion dollarë

Ekspozim ndërkombëtar dhe mundësi të reja tregtie dhe investimi

Platformë fizike + virtuale, ku do të vazhdoni të jeni të pranishëm edhe pas përfundimit të panairit

Edhe pas përfundimit të eventit fizik, IATF do të vazhdojë përmes një platforme interaktive online, ku mund të ekspozoni produktet, shërbimet dhe projektet tuaja për një vit të plotë.

Për më shumë informacion dhe për të shprehur interesin për pjesëmarrje, ju lutemi kontaktoni direkt me organizatorët:

<https://lnkd.in/dTgrtFbi>

customerservice@intrafricantradefair.com

WhatsApp: +27 764 430 401

